



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1303 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 205, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtimi i HEC "MARJAN GURRA E VESHËVE", në përroin Gurra e Veshëve, Bashkia Korçë"- subjekti "MARITUDA" sh.p.k.. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj,


VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtimi i HEC "MARJAN GURRA E VESHËVE", në përroin Gurra e Veshëve, Bashkia Korçë"- subjekti "MARITUDA" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti "MARITUDA" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për HEC "MARJAN GURRA E VESHËVE", në përroin Gurra e Veshëve, Bashkia Korçë si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Kruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al